



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 Nr. 352-9656/20

Date 08/05/2020

KONTRATA PUBLIKE nr. 015-2020

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; Nr Bisnesi 07000032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

Dhe

GLLAREVA SHPK, KLINE ne tekstin e metejme kontraktuesei me numer biznesi dhe numer fiskal 811281865, me perfaqesues z. BUJAR MORINA .

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për FURNIZIMIET EMERGJENTE në vijim:


FURNIZIM ME MATERJAL DEZINFEKTIMI PER NEVOJA TE ADMINISTRAES

me numër identifikues: **634-20-016-147**

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e FURNIZIMEVE - në vijim:



II. Cmimoret per njesi .

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	DORZA HIXHENIKE 1/100	3.70	16	PAKO	59.20
2	DEZINFEKTUES	1.90	168	COPE	319.20
3	SAPUN TE DUAREVE I LANGET	0.89	48	COPE	42.72
4	SHAMPON ANTIBAKTERIAL	0.87	48	COPE	41.76
5	LECKA TE LENGETA	0.78	130	COPE	101.40

Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera eshte sipas planifikimit deri 564.28€
(Peseqindegjashtedhjetekatereuroe 28/100)

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i perditeshem sipas përshkrimit te detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate eshte **Menjehere**

Neni 3 Çmimi

3.1. Cmimet jane per njesi .

3.2 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit te punimeve sipas kontratës publike.

3.4 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Pagesa do të bëhet në Euro

- Pas përfundimit te furnzmeve me Fatur- Raport nga pranuesi i mallrave .

4.2..Dhe ate me fature dhe Raport mbi kryerje te shërbimeve, Jo me larg se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *sherbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i puneve do të jetë përgjegjës për Demtimet të shkaktuara me dashje apo pa kujdesi në masen e demit që do të përcaktohet nga zyrtari përgjegjës .

Neni 7 Inspektimi dhe testimi

7.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bera nëse është në masen e cilesive të kërkuara .

Neni 8 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

8.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

8.2. Apo në ndonjë nga rastet e fuqisë madhore , Ndikimet Natyrore apo raste tjera të paparashikuara .

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë

12.2 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 13. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontratës .

13.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kerkuese -Implementuese Drejtoria ADMINISTRATES .


13.2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrates me vendim te ZKA do te jete : _____ nga _____

13.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA KLINE

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08.05.2020
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve : GLAREVA SPK – KLINE

Emri:	BUJAR MORINA
Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:	
Data:	08.05.2020
Vula:	

